



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 1478 Prot.,

Tiranë, më 16.09.2024

Lënda: Dërgohet raporti 8 – mujor për vitin 2024 mbi monitorimin e buxhetit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
Rruga “Dëshmorët e 4 shkurtit”, Tiranë

Të nderuar,

Në zbatim të udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 “Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, shtojca 3, po ju paraqesim informacionin narrativ mbi monitorimin e buxhetit për periudhën janar – gusht 2024, për AIDA-n.

1. Hyrje.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në mbështetje të ligjit nr. 10303, datë 15.07.2010 “Për krijimin dhe Mënyrën e Funkcionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve” ka për qëllim të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues të vendit, promovimin dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, si dhe të promovojë potencialin turistik të vendit.

AIDA deri në përfundim të vitit ushtrimor 2023, ka qenë pjesë e planit buxhetor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Grupi 10. Në fillim të vitit 2024, me hyrjen në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 17.01.2024 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit" dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 17.01.2024 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë të Ministrisë së Financave", institucioni ynë u klasifikua si pjesë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, grupi 12.

Në vijim, me shkresën e Ministrisë së Financave me nr. 2917/1 prot., datë 12.03.2024, na u komunikua dhe ndryshimi i kodeve të institucionit, duke u shoqëruar me nje proces gati I (një) mujor të transferimit të fondeve nga kodi i institucionit si pjesë e Grupit 10 (MF), në kodin e ri të institucionit si pjesë e Grupit 12 (MEKI).

Në zbatim të Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023, të sipërcituar, lidhur me raportimin mbi monitorimin e buxhetit 8 mujor, sqarojmë se shpenzimet buxhetore të kryera nga ana jonë për këtë periudhë raportuese janë të ndara në dy grupe buxhetore, konkretisht për periudhën janar – mars 2024, fondet janë akorduar dhe shfrytëzuar si pjesë e Grupit 10 (MFE), ndërsa gjatë muajit prill – gusht 2024, fondet e papërdorura brenda limitit vjetor të miratuar me ligjin nr. 97/2023, janë mbartur dhe shfrytëzuar në Grupin 12 (MEKI).

1. Informacioni buxhetor i agreguar

AIDA, në zbatim të Ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 "Për sistemin e menaxhimit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 "Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore", si dhe ligjit nr.10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve" (AIDA), gjatë periudhës raportuese janar – gusht 2024, ka administruar dhe menaxhuar fondet e vëna në dispozicion nga 2(dy) burime:

A. Buxheti i Shtetit në masën **256,860,000 lekë**, ku përkatësisht në masën 199,860,000 lekë për shpenzime korrente lidhur me objektin e veprimtarisë së AIDA-s, konkretisht;

- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit;

- Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

dhe 57,000,000 lekë për shpenzime për investime me kapital të brendshëm

Fondet në fjalë gjatë periudhës raportuese kanë pësuar këto shtesa dhe pakësime:

- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) me nr. 3499/1 prot., datë 28.03.2024, protokolluar këtu me nr. 506, datë 02.04.2024, "Mbi detajimin e fondit të veçant", është shtuar fondi i llogarisë ekonomike 606 0000 në masën **120,000 lekë**.
- Me shkresën e Ministrisë së Financave me nr. 5662/1 prot., datë 08.05.2024 është miratuar saktësimi i llogarisë ekonomike të fondeve të akorduara në 4 (katër) projektet e investimeve në masën 51,830,000 lekë, nga llogaria 230 0000 në llogarinë 231 0000.

Rruga "Skerdilajd Llagami", Nd.1, H.6, Tiranë

Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

- Me shkresën e Ministrisë së Financive me nr. 10356/1 prot., datë 07.08.2024, është përcjellë miratimi i rialokimit të fondeve, konkretisht, shtuar llogaria 602 në masën 4,000,000 lekë, pakësuar llogaritë 600 0000 dhe 601 0000 në masën 2,000,000 lekë/sejcila.
- Me shkresën e Ministrisë së Financive me nr. 10001/1 prot., datë 08.08.2024, miratuar ndryshimi i destinacionit të fondit të investimit prej 2,000,000 lekë në projektin ‘Përmirësim sistemesh’, duke e pakësuar dhe shtuar projektin e ri “Blerje pajisje elektronike AIDA”, në masën 2,000,000 lekë.

B. Financim i huaj në masën **8,300,000 lekë** për shpenzime për investime me kapital të jashtëm (projekti Skills for Jobs Albania Montenegro). Gjatë kësaj periudhe raportimi nga donatori është disbursuara fondi në masën 2,430,031.75 lekë, ndërkohë për mbajtjen e aktiviteteve referuar projektit janë shpenzuar 3,423,292 lekë.

Aktualisht fondi i parashikuar për vitin 2024, për AIDA-n është në total në masën **265,280,000 lekë**.

- **Performanca e AIDA-s gjatë periudhës raportuese janar – gusht 2024**

Gjatë këtij 8-mujori të vitit 2024, AIDA ka shënuar rritje në nivel performance, si në aktivitetet përfaqësuese me palë të treta, ashtu edhe në përkrahjen e investitorëve vendas dhe të huaj.

a) Performanca e produktit: “Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit”.

- **Pjesëmarrje në panairë brenda dhe jashtë vendit:**

1. Brenda vendit:

1.1. Panairi “Dita e Bujqësisë”, në Lushnje, në muajin prill 2024, AIDA bëri prezantimin e shërbimeve të veta ndaj shumë bizneseve pjesëmarrëse vendase dhe të huaj, duke krijuar ura të vlefshme bashkëpunimi për të ardhmen.

1.2. Panairi “Agro Tech & Natyral”, në Farkë, në muajin maj 2024, AIDA në këtë edicion të bashkoj fermerët, prodhuesit, shpërndarësit, artizanët në funksion të bujqësisë dhe konsumatorëve, për të nxitur shkëmbimin e njohurive, rritjen e biznesit dhe angazhimin e komunitetit. Stenda e AIDA ishte e përbashkët me 10 (dhjetë) kompani NMVM, të cilat bënë të mundur ekspozimin, promovimin dhe degustimin e produkteve të tyre.

2. Jashtë vendit:

2.1. Panairi ndërkombëtar “Biofach 2024”, në Gjermani, në muajin shkurt 2024, ku kanë përfituar 6 (gjashtë) biznese shqiptare të cilët synojnë ndërkombëtarizimin e produkteve të tyre, duke nxitur eksportin;

2.2. Panairi ndërkombëtar ‘MOMAD 2024’, në Spanjë, për të cilin është konkluduar rezervimi i stendës dhe pajisjet suportuese logjistike, në të cilën pritet të marrin pjesë 4 (katër) biznese shqiptare. Ky panair pritet të zhvillohet në muajin shtator 2024;

2.3. Panairi ndërkombëtar ‘FI NORTH 2024’, në Amerikë, për të cilin është konkluduar vetëm rezervimi i stendës, në të cilën pritet të marrin pjesë 8 (tetë) biznese shqiptare. Ky panair do të zhvillohet në muajin tetor 2024.

-Takime dhe tryeza me prodhues vendas dhe institucione partnere në nxitjen e investimeve dhe mbështetjen e investitorëve.

Konkretisht gjatë kësaj periudhë, janë mbajtur takime në formë tryeze të rrumbullakët me biznese të fushave të ndryshme, ku janë diskutuar problematikat që asin ata në punën e përditshme dhe janë propozuar nisma konkrete nga AIDA për t’ju ardhur në ndihmë.

Lidhur me prodhuesit vendas “Made in Albania”, janë mbajtur;

-Tryeza diskutimi me prodhues të vajit të ullirit, mjaltit dhe përpunimit të qumështit;

-Tryeza diskutimi me prodhues të sektorit të lëkurës dhe këpucëve;

-Tryeza diskutimi me prodhues të verës;

Gjithashtu është mbajtur tryeza e rrumbullakët në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale (DPPI), në lidhje me ndërgjegjësimin e bizneseve shqiptare për të rritur vlerat përmes pronësisë intelektuale.

Ndërkohë në javën e fundit të muajit prill, u mbajt tryeza e rrumbullakët “Automotiv Day”, në të cilën u diskutuan problematikat e sektorit të prodhimit të pjesëve të ndryshme të makinave, si dhe vështirësit që ata hasin gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre. Takimi u mbajt në kuadër të fushatave After Care dhe përkujdesjen ndaj investitorëve vendas dhe të huaj që operojnë në këtë sektor.

Nga ana tjetër gjatë kësaj periudhë AIDA ka qenë pjesë e organizimit të Forumit të Biznesit të mbajtur me investitor të huaj arab dhe cek, nëpërmjet takimeve B2B, ku ka asistuar dhe ndihmuar kompanitë shqiptare për të lidhur ura komunikimi dhe bashkëpunimi me këto biznesmen të huaj.

Nga diskutimet dhe nevojat e rezultuara nga tryezat e mbajtura gjatë muajit prill me prodhues vendas, AIDA gjatë muajit maj organizoi eventin “Zgjidh të vendit”, duke bërë bashkë aktorët e biznesit dhe politik bërësit. Qëllimi i këtij eventi ishte përfshirja e produkteve vendase në menut e hoteleve dhe restoranteve si dhe në politikat promovuese tek turistët e huaj.

Sa i përket tërheqjes së investitorëve të huaj në Shqipëri, gjatë muajit qershor 2024, AIDA organizoj në Madrid dhe Barcelon, të Spanjës, fushatën outreach me fokus sektorin e turizmit. Kjo fushatë u organizua në bashkëpunim me Racional Cooperation Council (RCC) dhe World Bank Group.

b) Performanca e produktit “Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” (shpenzime korente) dhe 4 (katër) projekteve të financimit: “Fondi i Inovacionit”, “Fondi i Konkurueshmërisë”, “Fondi Start Up” dhe “Fondi i Ekonomisë Kreative” (shpenzimeve kapitale).

Gjatë muajit shkurt – maj 2024 është finalizuar procesi i draftimit të VKM-s “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr 539, datë 29.07.2022 “Për krijimin, funksionimin, shpërblimin e anëtarëve të bordit vlerësues të kërkesave, si dhe procedurën konkurruese për dhënien e granteve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme” dhe VKM-s “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kritereve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2024”. Në vijim, në muajin qershor 2024, me VKM nr. 407 dhe nr. 408, datë 19.06.2024 është bërë miratimi i tyre në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

Gjatë muajit korrik – gusht 2024 është përmbyllur procesi i shpalljes publike dhe fushatës së marketimit të thirrjes për aplikim për grante nga 2(dy) skemat e mbështetjes. Paralelisht me fushatën e informimit nëpërmjet rrjeteve sociale, janë mbajtur disa seksione informuese nga stafi AIDA-s në Tiranë dhe nëpër qytete kryesore si, Shkodër, Lezhë, Pogradec, Korçë, Vlorë dhe Fier. Në mbyllje të muajit gusht është finalizuar dhe procesi i shqyrtimit të aplikimeve nga Njësia e Menaxhimit të Fondeve ngritur në AIDA. Disbursimi i transhit të parë të fondeve të akorduara për këto grante pritet të filloj në muajin shtator 2024.

c) Përformanca e projektit “Përmirësim sistemesh”, nga zëri shpenzime kapitale (Ilogaria 231).

Fondi në dispozicion prej 2,000,000 lekë për projektin “Përmirësim sistemesh”, nuk ka mundur të hidhet për prokurim publik në vitin 2024 pasi ky zë lidhet me mirëmbajtjen e sistemit të Regjistrimit të Investimeve Strategjike, i cili nuk u finalizua vitin e kaluar. Ndaj me shkresën tone nr. 868 prot., datë 24.06.2024 “Kërkesë për ndryshim destinacioni të fondit të akorduar për projektin me financim të brendshëm ‘Përmirësim sistemesh’, pjesë e programit ekonomik “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, kemi kërkuar ndryshim destinacioni të këtij fondi. Konkretisht u kërkuar alokimi i fondit prej 2,000,000 lekë për projektin “Blerje pajisje elektronike AIDA”. Kjo kërkesë erdhi në kuadër të riskstrukturimit të AIDA-s, proces i cili pritet të shoqërohet me shtesë stafi me rreth 12 punonjës të rinj. Kërkesa jonë u miratua nga MEKI dhe me shkresën e MF me nr. 10001/1 prot., datë 08.08.2024, fondit ju ndryshua destinacioni. Në vijim me shkresën tonë me nr.1393/2 prot., datë 16.08.2024 drejtuar AKSHI-t, kemi kërkuar ndjekjen e procedurës të prokurimit të fondit prej 1,666,666 lekë pa TVSH sipas sasive dhe specifikimeve të kërkuara nga AIDA. Brenda vitit 2024, pritet përmbushja e plotë e këtij projekti.

d) Përformanca e projektit me financim të huaj “Skills for jobs Albania Montenegro” dhe projekti “TVSH për projekte me financim të huaj” nga zëri shpenzime kapitale (Ilogaria 231).

✓ **Projektet me financim të huaj.**

Përsa i përket projekteve me financim të huaj për vitin 2024, sqarojmë si më poshtë:

- Në lidhje me projektin me financim të huaj me emërtim “Skills for jobs Albania - Montenegro” në buxhetin e AIDA-s për vitin 2024 u parashikuar financimi i huaj prej 8,300,000 lekë. Ndërkohë fondet e disbursuara nga donator për këtë projekt për periudhën

Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë

Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

raportuese në masën 2,430,031.75 lekë dhe të shpenzuara janë 3,423,292 lekë. Sipas Udhëzimit nr. 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, AIDA ka kryer raportimin e ecurisë së këtij projekti në MEKI dhe MF duke respektuar afatet e përcaktuara.

- Në lidhje me projektin me financim të huaj me emërtimin “EEN Albania”, i cili është mbyllur prej dhjetorit të vitit 2021, fondi i mbetur gjendje kreditore në bankën e nivelit të dytë është transferuar në llogarinë speciale të Bankës së Shqipërisë (BSH) të hapur në emër të këtij projekti, më tej me shkresën tonë me nr. 867, datë 24.06.2024 kemi kërkuar transferimin e këtij fondi si të ardhura dytësore të AIDA-s, për tu përdorur për shpenzime korente në kapitullin 6. Kërkesa jonë është miratuar nga MF dhe aktualisht fondi prej 3,542,205.36 lekë është celur si disponibilitet në llogarinë e AIDA –s pranë degës së thesarit në artikullin 602, kapitulli 6.

✓ TVSH për projekte me financim të huaj

Në zbatim të aktiviteteve në kuadër të implementimit të projektit me financim të huaj “Skills for jobs Albania Montenegro”, gjatë periudhës raportuese është kompensuar nga projekti “TVSH për projekte me financim të huaj” detyrimi lindur për pagesë fature me vlerë të TVSH-s në masën 4,667 lekë,

3. Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore, në nivel produkti

Objekti i veprimtarisë të AIDA-s, në buxhetin e akorduar për vitin 2024, konkretisht produkti jo projekt “Grante për mbështetjen e bizneseve” dhe në produktet të ndarë në 4(katër) projekte, ka parashikuar trajtime me bazë gjinore, indikator të cilët do jenë të matshëm në përfundim të procesit të shpërndarjes së granteve nga këto dy skema dhe do pasqyrohen në monitorimin e buxhetit vjetor.

Ndërkohë pjesa tjetër e aktiviteteve që zhvillon AIDA në rolin e promovueses të Shqipërisë si destinacion për investime, lidhet me targetimin dhe asistencën që ofrohet për investitorët vendas dhe të huaj, praktikë e cila nuk bën diferencim me bazë gjinore.

4. Performanca e buxhetit në nivel programi - AIDA

- REALIZIMI I SHPENZIMEVE KORENTE DHE KAPITALE SIPAS TAVANEVE BUXHETORE PËR PERIUdhËN JANAR – GUSHT 2024

Në lekë

Artikulli	EMËRTIMI	VLERA NË FILLIM TË VITIT NË BUXHET	VLERAT PAS NDRYSHIMEVE	FAKTI I REALIZIMIT TË BUXHETIT		FAKTI SHPENZIM E THESAR JANAR – GUSHT (I+II)	PËRQIND JA E REALIZIMIT (%)
				JANAR – MARS (I)	PRILL - GUSHT (II)		
600	Paga	53,186,000	51,186,000	11,007,498	17,823,859	28,831,357	56

Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë

Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

601	Sigurime Shoqërore	12,124,000	10,124,000	1,798,363	2,902,885	4,701,248	46
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	34,502,000	38,502,000	5,231,275	15,016,048	20,247,323	53
604	Grante për mbështetje në bizneseve	100,000,000	100,000,000	0	0	0	0
606	Transferta për Buxhetet Familjare & Individ	48,000	168,000	0	16,300	16,300	10
A. Total 600-606		199,860,000	199,980,000	18,037,136	35,759,092	53,796,228	27
230	Shpenzime për rritjen e aktiveve qendrore të patrupëzuar a	51,830,000	0	0	0	0	0
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve qendrore të trupëzuara	13,470,000	65,300,000	1,093,828	2,334,141	3,427,959	5
B. Total 230-231		65,300,000	65,300,000	1,093,828	2,334,141	3,427,959	5
TOTAL (A+B)		265,160,000	265,280,000	19,130,964	38,093,233	57,224,187	22
Kapitulli 6		5,230,362	8,967,167	0	437,122	437,122	5

Gjatë periudhës raportuese, ecuria (performanca) e realizimit të shpenzimeve korente dhe kapitale sipas klasifikimit ekonomik dhe sipas burimeve të financimit, ka patur këtë rezultat:

- **Shpenzime për paga (artikulli 600):** është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 56% të fondit të rishikuar për vitin 2024.
- **Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore (artikulli 601):** është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 46% të fondit të rishikuar për vitin 2024.
- **Shpenzime për mallra dhe Shërbime të Tjera (artikulli 602):** është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 53% të fondit të rishikuar për vitin 2024. Përpos nevojave

dhe prokurimeve përkatëse, në këtë zë janë realizuar shpenzimet për pjesëmarrje në konferenca dhe panaire, realizimin e aktiviteteve dhe të tjera në përputhje me veprimtarinë dhe fokusin e agjencisë.

- **Grante për mbështetje të bizneseve (artikulli 604):** Në vijim të VKM 407 dhe 408, datë 19.06.2024, AIDA, gjatë muajit korrik - gusht ka finalizuar procesin e shpalljes së thirrjes për aplikim për grante, mbledhjen dhe shqyrtimin e aplikimeve të vlefshme. Aktualisht pritet finalizimi i procesit të përzgjedhjes së NMVM-ve fituese për të lidhur marrëveshjet dhe nisjen e procesit të disbursimit të fondeve nga ky zë. Brenda vitit 2024, pritet të arrihet realizimi 100% i këtij zëri.
- **Transferta për Buxhetet Familjare & Individ (artikulli 606):** gjatë periudhës raportuese në masën 10% të fondit të akorduar për vitin 2024, në zbatim të VKM nr. 673, datë 02.09.2020 "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë". Për periudhën raportuese nuk ka patur shpenzime nga fondi i veçant.
- **Shpenzimet kapitale në artikullin 231:**
 - I. **Me financim të brendshëm:** Fondet e parashikuara për këtë artikull janë të ndara në:
 - 4 (katër) projektet e financimit për mbështetjen e NMVM-ve për projekte kapitale për mbështetjen me grante për fuqizimin e NVMV-ve. Këto fonde priten të disbursohen gjatë periudhës shtator – dhjetor 2024, sipas të njëjtës praktikë të sqaruar më lartë për artikullin 604.
 - Investimin e brendshëm në masën 2,000,000 lekë, e cila u kanalizua gjatë muajit gusht 2024 për zërin "Blerje pajisje elektronike AIDA" dhe pritet të finalizohet si projekt nga AKSHI gjatë periudhës shtator – dhjetor 2024.
 - II. **Me financim të huaj për projektet:**
 - Me emërtim "Skills for jobs Albania - Montenegro" në buxhetin e AIDA-s për vitin 2024 u parashikuar financimi i huaj prej 8,300,000 lekë. Ndërkohë fondet e disbursuara nga donator për këtë projekt për periudhën raportuese janë në masën 2,430,031.75 lekë dhe të shpenzuara janë 3,423,292 lekë. Për këtë projekt AIDA ka shpenzuar si bashkëfinancim shumë prej 4,667 lekë për rimbursim TVSH.
 - Me emërtimin "EEN Albania", project i cili është mbyllur në dhjetor të vitit 2021. Por duke qenë se në llogarinë e Bankës të nivelit të dytë Raiffeisen Bank, rezultonte një gjendje kreditore e mbetur si rimbursim shpenzimet për fondet e vëna në dispozicion nga AIDA gjatë implementimit të projektit, kemi marrë masat për transferimin e këtij fondi në BSH dhe më tej është bërë kalimi i shumës prej 3,542,205 lekë në të ardhura jashtë limit për AIDA-n.

- **REALIZIMI I TË ARDHURAVE PËR PERIUDHËN JANAR – GUSHT 2024**

Në zbatim të ligjit nr 55/2015 "Per investimet strategjike ne Republiken e Shqiperise" dhe VKM nr. 1027, date 16.12.2015 "Per tarifat e sherbimeve per investimet strategjike" përfiton të ardhura nga shërbimet e asistencës së kryera pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për aplikimet për investitor strategjik. Referuar këtyre tarifave, Agjencia për 8-mujorin e vitit 2024, për shërbimet e kryera ka përfituar dhe derdhur në Buxhetin e Shtetit nga shoqëritë aplikuese për investitor strategjik tarifa në vlerën totale prej **1,020,000 lekë**.

Ndërkohë gjatë kësaj periudhe raportimi AIDA ka përfituar të ardhura jashtë limit për tu përdorur nga institucioni nga dy burime:

1. **Ragional Cooperation Council (RCC)** në bazë të akt marrëveshjes me nr. 510/1 prot., datë 03.04.2024, në kuadër të “*Fushatën informuese për tërheqjen e investimeve të huaja direkte të qëndrueshme (IHD), duke çuar në rritjen e aktivitetit ekonomik, shkëmbimin e njohurive teknologjike dhe ndikime pozitive rajonale, me qëllimin përfundimtar të krijimit të vendeve të punës dhe përmirësimit të mirëqenies në Ballkanin Perëndimor*”, gjatë periudhës raportuese është akorduar fondi prej 194,600 lekë.

2. **Projekti me financim të huaj “EEN Albania”** në mbyllje të implementimit të tij, në llogarinë e bankës së nivelit të dytë ku administroheshin fondet nga ky projekt, rezultonte një gjendje kreditore prej 3,608,616.8 lekë. AIDA me shkresën me nr. 867 prot., datë 24.06.2024, drejtuar Ministrisë së Financave parashtrori nevojën për akordimin e këtyre fondeve si të ardhura për institucionin, për tu përdorur për shpenzime korente nga kapitulli 6. Aktualisht në gjendjen e llogarisë të AIDA-s të kapitullit 6 është shtuar vlera prej 3,542,205 lekë.

Total shtesa në kapitullin 6 gjatë periudhës raportuese është në masën **3,736,805 lekë**.

5. Performanca jo - financiare e programit buxhetor

Nga analiza sasiore e realizimit të objektivit në nivel produkti, për disa tregues AIDA ka arritur nivelet e pritshme. Ndërkohë disa nga treguesit e tjerë për arsye objektive nuk kanë patur arritjen e kërkuar.

Më poshtë po ju paraqesim analizën e performancës të produktit jo – projekt “*Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit*”, në nivel treguesish.

- Mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë;

Gjatë periudhës raportuese realizimi i treguesevë të performancës krahasuar me planin për këtë objektiv janë në një mesatare prej 34%. Ky realizim është në këto norma pasi deri në muajin prill 2024, ligji nr. 55/2015 ‘Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë’, ishte me afat të përfunduar për aplikimet për statusin e Investitorit Strategjik, ndaj gjatë periudhës janar – prill 2024, AIDA nuk ka pranuar aplikime të reja dhe as janë dhënë staturë të reja. Por theksojmë se gjatë kësaj periudhë Drejtoria e Investimeve, specifiku sektori i One Stop Shop ka punuar maksimalisht për ndjekjen e projekteve me status të miratuar dhe atyre në fazë asistimi. Gjithashtu aplikimet e reja janë ndjekur në çdo hap si nga shprehja e interesit deri në fazën përfundimtare të marrjes ose jo të statusit.

- Suportin e kompanive SME nëpërmjet fondeve;

Gjatë periudhës raportuese treguesit e performancës për këtë objektiv janë zero pasi sikurse e sqaruam dhe më lartë, AIDA gjatë muajit shkurt – maj 2024 finalizoi procesin e draftimit të VKM-s “*Mbi disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr 539, datë 29.07.2022 “Për krijimin, funksionimin, shpërblimin e anëtarëve të bordit vlerësues të kërkesave, si dhe procedurën konkurruese për*

dhënien e granteve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme” dhe VKM-s “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2024”. Në vijim, në muajin qershor 2024, me VKM nr. 407 dhe nr. 408, datë 19.06.2024 është bërë miratimi i tyre në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

Gjatë muajit korrik – gusht 2024 është përmbyllur procesi i shpalljes publike dhe fushatës së marketimit të thirrjes për aplikim për grante nga 2(dy) skemat e mbështetjes. Paralelisht me fushatën e informimit nëpërmjet rrjeteve sociale, janë mbajtur disa seksione informuese nga stafi AIDA-s në Tiranë dhe nëpër qytete kryesore si, Shkodër, Lezhë, Pogradec, Korçë, Vlorë dhe Fier. Në mbyllje të muajit gusht është finalizuar dhe procesi i shqyrtimit të aplikimeve nga Njësia e Menaxhimit të Fondeve ngritur në AIDA. Disbursimi i transhit të parë të fondeve të akorduara për këto grante pritet të filloj në muajin shtator 2024, si dhe finalizimi i procesit me disbursimin tërësor të këtyre fondeve pritet të bëhet brenda vitit 2024.

- *Nxitjen e Investimeve të Huaja direkte (IHD)*

Gjatë periudhën raportuese janar – gusht 2024, referuar dhe indikatorëve tregues të zbatimit të këtyre objektivave, AIDA ka arritur një shkallë të kënaqshme realizimi të këtyre indikatorëve prej rreth 55%. Konkretisht gjatë muajit maj 2024, AIDA me mbështetjen financiare të Ragional Cooperation Council (RCC), ka realizuar një fushatë outreach në Madrid dhe Barcelon të Spanjës, ku nga 10 kompani të targetuara u mbajt takim me 4 prej tyre. Nga ana tjetër gjatë periudhës raportuese janë mbajtur takime të shumta me biznese dhe njësi bashkiake në qytete të ndryshme të Shqipërisë në kuader të fushatave after care.

ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"

Periudha e Raportimit: 01.01.2024 deri 31.08.2024		Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve					
Objektivat e politikës:	Kodi i Programit	04130	Emerti mi i program it:	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik		Perqind ja e realizim it per 8- mujorin	
				**Treguesit e performancës/Produktet:			
					Plani 2024	FAKT I VITI 2024	

		Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emerti mi i Treguesit te Performances***/Produktit		8-mujori	
1	Mbështetja e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë	1.1	Numri i aktiviteteteve promovuese	91205A E	Numri i aktiviteteteve promovuese	10	6	60%
		1.2	Nr i kompanive aplikuese per status	91205A E	Nr i kompanive aplikuese	35	9	26%
		1.3	Nr i kompanive përfituese te statusit	91205A E	Nr i kompanive përfituese	20	3	15%
2	Nxitja e Investimeve të Huaja direkte (IHD)	2.1	Numri i takimeve after care te organizuara	91205A E	Numri i aktiviteteteve te organizuara	20	15	75%
		2.2	Zgjerimi i rrjetit dhe bashkepunimi me partnere	91205A E	Zgjerimi i rrjetit dhe bashkepunimi me partnere	2	1	50%
		2.3	Numri i kompanive dhe investitoreve te targetuar gjate fushata outreach	91205A E	Numri i kompanive dhe investitoreve te targetuar gjate fushata outreach	10	4	40%

3	Supor tin e komp anive SME nëpër mjet fonde ve	3.1	Numri i NVMV-ve te mbeshtetura me fonde publike	91205A B	Numer perfitues ish	86	0	0%
		3.2	Numri i NVMV me drejtuese femer qe ka perfituar nga fondet publike	91205A B	Numer perfitues ish	12	0	0%
		3.3	Numri i kompanive te asistuar ne Panaire brenda dhe jashte vendit	91205A E	Numer perfitues ish	30	16	53%

6. Përfundime dhe konkluzione

Në përfundim, AIDA deri në fund të vitit 2024 pritet të ndërmarrë aktivitete për arritjen e plotë të objektivave, si më poshtë:

- Finalizimin e procesit të ristrukturimit të AIDA-s, ku parashikohen shtime të funksioneve për njësitë në përbërje të organikës së re, për përmbushjen e objektivit të promovimit të Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit;
- Finalizimin e procesit të shpërndarjes së fondeve të akorduara për mbështetje me grantë të NVMV-ve nga projekte me fonde nga shpenzime korente dhe kapitale.
- Plotësimin e plotë të vendeve vakante në rast sigurimi Brenda këtij viti të kushteve logjistike për akomodimin e stafit shtesë sipas strukturës së re të AIDA-s;
- Realizimin e plotë të fondeve të akorduara për shpenzime korente dhe për investime publike sipas tavaneve buxhtore.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR EKZEKUTIV

LAURA PLAKU (SARO)

Rruga "Skerdilajd Llagami", Nd.1, H.6, Tiranë
Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al



ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit"
 Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Perioda e Raportimit: 01.01.2024 deri 31.08.2024

Objektivat e politikës	Kodi i Programit	04130	Emertimi i programit:	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik		Perqindja e realizimit për 8-mujorin			
				**Treguesit e	FAKTI				
			Kodi i Treguesit të Performancës**/Proes/Produktit	Emertimi i Treguesit të Performancës**/Proes/Produktit	Plani 2024 8-mujorin				
1			*Objektivat e politikës*:						
				1.1	Numbri i aktiviteteteve promovuese	91205AE	10	6	60%
				1.2	Nr i kompanive aplikuese per status	91205AE	35	9	26%
2			Nxjtja e Investimeve të Huaja direkte (IHD)	1.3	Nr i kompanive perfutuese te statusit	91205AE	20	3	15%
				2.1	Numbri i takimeve afer care te organizuara	91205AE	20	15	75%
				2.2	Zgjerimi i rrjetit dhe bashkepunimi me partnere	91205AE	2	1	50%
3			Suportin e kompanive SME nëpërmjet fondeve	2.3	Numbri i kompanive dhe investitoreve te targetuar gjate fushata outreach	91205AE	10	4	40%
				3.1	Numbri i NVMV-ve te mbeshitura me fonde publike	91205AB	86	0	0%
				3.2	Numbri i NVMV me drejtuese femer qe ka perfituar nga fondet publike	91205AB	12	0	0%
				3.3	Numbri i kompanive te asistuar ne Panarre brenda dhe jashte vendit	91205AE	30	16	53%



Emri: Laura Plaku (Suro)
 Firma:
 Data: 17.09.2024

Emri: Ertisa Ymerali
 Firma:
 Data: 17.09.2024

Drejtori Ekzekutiv

Nepunesi Zbatues